<p>bashku me informacionin mbi shërbimet e kualifikuar të besuara të ofruara prej tyre.</p> <p style="text-align: center;">Neni 28 Shenja e besueshmërisë për shërbimet e kualifikuara të besuara</p> <p>1. Shenja e besueshmërisë për shërbimet e kualifikuar të besuara është një shenjë me anë të së cilës identifikohen në mënyrë të thjeshtë dhe të qartë shërbimet e kualifikuara të besuara.</p> <p>2. Ofruesit e regjistruar të shërbimeve të kualifikuara të besuara kanë të drejtë të përdorin shenjën e besueshmërisë për shërbimet e besuara të kualifikuara që i ofrojnë.</p> <p>3. Forma, përmbajtja, madhësia dhe dizajni i Shenjës së besueshmërisë për shërbimet e kualifikuara të besuara përcaktohen me akt nënligjor.</p>	<p>information on the qualified trust services provided by them.</p> <p style="text-align: center;">Article 28 Credibility mark for qualified trust services</p> <p>1. The credibility mark for qualified trust services is a mark used to indicate in a simple and clear manner the qualified trust services.</p> <p>2. The registered qualified trust service providers shall have the right to use the trust mark for the qualified trust services they provide.</p> <p>3. The form, content, size and design of the trust mark for qualified trusted services shall be determined by a sub-legal act.</p>	<p>informacijom o kvalifikovanim uslugama od poverenja pružanih od njihove strane.</p> <p style="text-align: center;">Član 28 Oznaka poverljivosti za kvalifikovane usluge od poverenja</p> <p>1. Oznaka poverljivosti za kvalifikovane usluge od poverenja je oznaka putem koje se na veoma jednostavan i jasan način identifikuju kvalifikovane usluge od poverenja.</p> <p>2. Registrovani pružaoci kvalifikovanih usluga od poverenja imaju pravo da koriste oznaku poverljivosti za kvalifikovane usluge od poverenja koje pružaju.</p> <p>3. Oblik, sadržaj, veličina i dizajn Oznake poverljivosti za kvalifikovane usluge od poverenja određuju se podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 29 Kërkesat për ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar</p> <p>1. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar fillon të ofrojë shërbime të kualifikuara të besuara pas marrjes së statusit, i kualifikuar sipas paragrafit 3 të nenit 25 dhe plotësimit të kushteve dhe kriterëve që rrjedhin nga paragrafi 5 i këtij neni.</p>	<p style="text-align: center;">Article 29 Requirements for qualified trust service providers</p> <p>1. A qualified trust service provider shall begin to provide qualified trust services after obtaining qualified status under paragraph 3 of Article 25 and fulfilling the conditions and criteria under paragraph 5 of this Article.</p>	<p style="text-align: center;">Član 29 Zahtevi za kvalifikovane pružaoce usluge od poverenja</p> <p>1. Kvalifikovani pružaoce usluge od poverenja počinje da pruža kvalifikovane usluge od poverenja nakon dobijanja statusa, kvalifikovan u skladu sa stavom 3. člana 25. i ispunjavanja uslova i kriterijuma koji proizilaze iz stava 5. ovog člana.</p>

<p>2. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar duhet të dëshmoj:</p> <p>2.1. besueshmërinë dhe njohuritë e nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë si ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar;</p> <p>2.2. garancinë e nevojshme financiare për mbulimin e dëmeve mundshme;</p> <p>2.3. stafin e kualifikuar dhe</p> <p>2.4 përdorimin e produkteve të besueshme .</p>	<p>2. A qualified trust service provider shall prove it has:</p> <p>2.1. Reliability and knowledge necessary to exercise the activity as a qualified trust service provider;</p> <p>2.2. Financial warranty necessary to cover possible damages</p> <p>2.3. Qualified staff employed and</p> <p>2.4 Uses trust products.</p>	<p>2. Kvalifikovani pružalac usluge od poverenja treba da dokaže:</p> <p>2.1. poverljivost i neophodna znanja za obavljanje delatnosti kao kvalifikovani pružalac usluge od poverenja;</p> <p>2.2. neophodnu finansijsku garanciju za pokrivanje mogućih šteta ;</p> <p>2.3. kvalifikovano osoblje i</p> <p>2.4 korišćenje usluga od poverenja.</p>
<p>3. Ofruesi i kualifikuar shërbimit të besuar, sipas nevojës mund të punësoj edhe nënkontraktorë të cilët posedojnë ekspertizën, besueshmërinë, përvojën, kualifikimet dhe trajnimet e nevojshme mbi sigurinë dhe rregullat për mbrojtjen e të dhënave personale dhe të cilët zbatojnë procedurat administrative dhe të menaxhimit që u korrespondojnë standardeve evropiane ose ndërkombëtare;</p>	<p>3. A qualified trust service provider, when it is deemed necessary, may also employ sub-contractors who possess the required expertise, reliability, experience, qualifications and training in terms of security and rules for personal data protection, and who apply administrative and management procedures that correspond to European or international standards;</p>	<p>3. Kvalifikovani pružalac usluge od poverenja, u skladu sa potrebama može da zaposli i pod-ugovarače koji poseduju neophodnu ekspertizu, poverljivost, iskustvo, kvalifikacije i obuke o bezbednosti i pravilima o zaštiti ličnih podataka i koji sprovode administrativne procedure i procedure upravljanja koje odgovaraju evropskim ili međunarodnim standardima.</p>
<p>4. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar është i obliguar:</p> <p>4.1. të informoj Ministrinë për çdo ndryshim lidhur me ofrimin e shërbimeve të kualifikuara të besuara dhe ndërprerjejen eventuale të aktivitetit të tij;</p> <p>4.2. që çdo pale e cila kërkon të përdorë një shërbim të kualifikuar të besuar, t'i</p>	<p>4. A qualified trust service provider shall:</p> <p>4.1. inform the Ministry of any change in the provision of its qualified trust services and eventual interruption in its activity;</p> <p>4.2. before entering into a contractual relationship, inform any person seeking</p>	<p>4. Kvalifikovani pružalac usluge od poverenja je u obavezi:</p> <p>4.1. da informiše Ministarstvo o bilo kojoj izmeni u vezi sa pružanjem kvalifikovanih usluga od poverenja i eventualno prekidanje njegove aktivnosti;</p> <p>4.2. da svaka strana koja zahteva korišćenje kvalifikovane usluge od</p>

<p>jap informacion mbi kushtet dhe kufizimet e përdorimit të atij shërbimi, para se të hyjë në një marrëdhënie kontraktuale;</p> <p>4.3. të përdorë sisteme dhe produkte të besueshme që janë të mbrojtura nga modifikimi dhe që garantojnë sigurinë teknike dhe besueshmërinë e proceseve të mbështetura prej tyre;</p> <p>4.4. të përdorë sisteme të besueshme dhe të verifikueshme për ruajtjen e të dhënave, që mundësojnë :</p> <p>4.4.1. rivënjen në dispozicion të publikut të të dhënave , pasi që të jetë marrë pëlqimi i personit të cilit i përkasin ato,</p> <p>4.4.2 shtimin dhe ndryshimin e tyre vetëm nga personat e autorizuar;</p> <p>4.4.3. kontrollimin e autenticitetit tyre;</p> <p>4. 5. të ketë një plan të azhurnuar lidhur me ndërprerjen e ofrimit të shërbimit dhe sigurimit të vazhdimësisë në përputhje me dispozitat e verifikuara nga Ministria;</p> <p>4.6. krijoj, mbaj dhe përditësoj një bazë të të dhënave mbi certifikatat e lëshuara, skaduara apo revokuara e cila duhet të jetë publike;</p>	<p>to use a qualified trust service of the precise terms and conditions regarding the use of that service, including any limitations on its use;</p> <p>4.3. use trustworthy systems and products that are protected against modification and ensure the technical security and reliability of the processes supported by them;</p> <p>4.4. use trustworthy and verifiable systems to store data provided to it so that:</p> <p>4.4.1. they are publicly available for retrieval only where the consent of the person to whom the data relates has been obtained,</p> <p>4.4.2 only authorised persons can make entries and changes to them;</p> <p>4.4.3. they can be checked for authenticity;</p> <p>4.5. have an up-to-date plan to terminate service provision and to ensure continuity of service in accordance with provisions verified by the Ministry;</p> <p>4.6. establish and keep updated a database on issued, expired or revoked certificates, which should be public;</p>	<p>poverenja, dajë informaciu o uslovima i ograničenjima korišćenja te usluge, pre stupanja u ugovorni odnos;</p> <p>4.3. da koristi sisteme i proizvode od poverenja koji su zaštićeni modifikacijom i koji garantuju tehničku bezbednost i poverljivost procesa koje podržavaju;</p> <p>4.4. da koristi poverljive i verifikovane sisteme za čuvanje podataka, koji omogućavaju:</p> <p>4.4.1. ponovno stavljanje na raspolaganje podataka javnosti, nakon dobijanja saglasnosti lica kome pripadaju isti;</p> <p>4.4.2 njihovo dodavanje i izmenjivanje samo od strane ovlašćenih lica;</p> <p>4.4.3. kontrolisanje njihove autentičnosti;</p> <p>4.5. Da ima ažuriran plan u vezi sa prekidanjem pružanja usluge i osiguranja kontinuiteta u skladu sa odredbama verifikovanim od strane Ministarstva;</p> <p>4.6. uspostavi, čuva i ažurira bazu podataka o izdatim, isteklim ili opozvanim sertifikatima koja treba da bude javna;</p>
---	---	--

<p>4.7. të marrë masat e duhura kundër falsifikimit dhe vjedhjes së të dhënave;</p> <p>4.8. t'i regjistrojë dhe të i ruaj për një periudhë të caktuar kohore dhjetë (10) vjet pas ndërprerjes së veprimtarisë si ofrues i shërbimit të kualifikuar të besuar; të gjitha dhënat relevante në lidhje me shërbimet e ofruara dhe pranuar, me qëllim të përdorimit si dëshmi në procedurat ligjore dhe për vazhdimësinë e shërbimit.</p> <p>5. Kushtet dhe kriteret që duhet të i përmbushin ofruesit e kualifikuar të shërbimit të besuar, përcaktohen me akt nënligjor.</p>	<p>4.7. take appropriate measures against forgery and theft of data;</p> <p>4.8. record and keep accessible for an appropriate period of time ten (10) years, including after the activities of the qualified trust service provider have ceased, all relevant information concerning data issued and received by the qualified trust service provider, for the purpose of providing evidence in legal proceedings and for the purpose of ensuring continuity of the service;</p> <p>5. The terms and conditions to be met by qualified trust service providers shall be defined by means of a sub-legal act.</p>	<p>4.7. da preduzme odgovarajuće mere protiv falsifikovanja i krađe podataka;</p> <p>4.8. da registruje i čuva za određeni vremenski period deset (10) godine nakon prekida delatnosti kao pružaoč kvalifikovane usluge od poverenja; svi relevantni podaci u vezi sa primljenim ili pružanim uslugama, sa ciljem korišćenja kao dokaz u zakonskim procedurama i za kontinuitet usluge,</p> <p>5. Uslovi i kriterijumi koje treba da ispune kvalifikovani pružaoči usluga od poverenja, određuju se podzakonskim aktom.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 30</p> <p style="text-align: center;">Transferimi i detyrave të ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar</p> <p>1. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar, në pamundësi të ushtrimit të aktivitetit të tij, mund të i transferoj detyrat e tij të parapara me këtë ligj dhe me aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, te një ofrues tjetër i shërbimeve, nëse këta i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj për ushtrimin e aktivitetit të njejtë.</p> <p>2. Transferimi nuk e përjashton nga përgjegjësia ofruesin paraprak të shërbimit prej detyrimeve që rrjedhin nga ky ligj.</p>	<p style="text-align: center;">Article 30</p> <p style="text-align: center;">Transfer of a qualified trust service provider duties</p> <p>1. A qualified trust service provider, being unable to exercise its activity, may transfer the duties provided by this law and the sub-legal acts issued for its implementation to another service provider, if they meet conditions provided by this law on the exercise of the same activity.</p> <p>2. The transfer does not exclude the preliminary service provider from the liabilities deriving from this law.</p>	<p style="text-align: center;">Član 30</p> <p style="text-align: center;">Prenošenje obaveza kvalifikovanog pružaoca usluge od poverenja</p> <p>1. Kvalifikovani pružalac usluge od poverenja, u nemogućnosti obavljanja svoje aktivnosti, može da prenese svoje obaveze koje su predviđene ovim zakonom i podzakonskim aktima izdatim za njegovo sprovođenje, drugom pružaoču usluga, ukoliko ispunjava uslove koji su predviđeni ovim zakonom za obavljanje iste aktivnosti.</p> <p>2. Prenošenje ne isključuje od odgovornosti prethodnog pružaoca usluge od obaveza koje proizilaze iz ovog zakona.</p>

<p>3. Kur ofruesi i kualifikuar i shërbimit besuar informon paraprakisht përdoruesin mbi transferimin e detyrave nga paragrafi 1 i këtij neni te ofruesi tjetër i shërbimeve kualifikuar i besuar, atëherë ai nuk është përgjegjës për dëmet që rrjedhin nga përdorimi i shërbimeve që tejkalojnë kufizimet e lejuara.</p> <p style="text-align: center;">Neni 31 Raportimi i ofruesit të kualifikuar të shërbimit të besuar</p> <p>1. Çdo ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar duhet të paraqet një raport vjetor, jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës.</p> <p>2. Ofruesi i kualifikuar i shërbimit të besuar i raporton Ministrisë sa herë që i kërkohet informacion.</p>	<p>3. When a qualified trust service provider informs beforehand the user on the transfer of duties from paragraph 1 of this Article to another qualified trust service provider, he shall not be liable of damages resulting from the use of services exceeding the permitted limitations.</p> <p style="text-align: center;">Article 31 Reporting of qualified trust service providers</p> <p>1. Any qualified trust service provider shall submit an annual report, not later than 31st of March of the following year.</p> <p>2. Qualified trust service provider reports to the Ministry whenever the latter asks for information.</p>	<p>3. Kada kvalifikovani pružalac usluge od poverenja prethodno informiše korisnika o prenošenju obaveza iz stava 1. ovog člana kod drugog pružaoca kvalifikovanih usluga od poverenja, onda on nije odgovoran za štetu nastalu od korišćenja usluga koja prekoračuju dozvoljena ograničenja.</p> <p style="text-align: center;">Član 31 Izveštavanje kvalifikovanog pružaoca usluge od poverenja</p> <p>1. Svaki kvalifikovani pružalac usluge od poverenja treba da podnosi godišnji izveštaj, najkasnije do 31. marta naredne godine.</p> <p>2. Kvalifikovani pružalac usluge od poverenja izveštava Ministarstvo kad god se zahteva informacija.</p>
<p>KAPITULLI IV NËNSHKRIMI ELEKTRONIK</p> <p style="text-align: center;">Neni 32 Efekt i juridik i nënshkrimit elektronik</p> <p>1. Nënshkrimi elektronik konsiderohet i vlefshëm dhe i pranueshëm dhe nuk mund t'i mohohet vlefshmëria ose pesha e provës vetëm se është në formë elektronike dhe nuk i plotëson kërkesat për nënshkrim të kualifikuar elektronik.</p>	<p>CHAPTER IV ELECTRONIC SIGNATURE</p> <p style="text-align: center;">Article 32 Legal effects of electronic signatures</p> <p>1. An electronic signature shall be considered valid and acceptable, and the validity or the weight of the proofs may not be denied solely because it is in an electronic form and does not meet requirements for qualified electronic signature.</p>	<p>POGLAVLJE IV ELEKTRONSKI POTPIS</p> <p style="text-align: center;">Član 32 Pravni efekat elektronskog potpisa</p> <p>1. Elektronski potpis se smatra validnim i prihvatljivim i ne može se negirati validnost i težina dokaza samo zato što je u elektronskom obliku i ne ispunjava zahteve za kvalifikovani elektronski potpis.</p>

<p>2. Nënshkrimi i kualifikuar elektronik ka të njëjtin efekt ligjor si nënshkrimi i dorës dhe mund të e zëvendësojë atë.</p> <p style="text-align: center;">Neni 33 Nënshkrimi i avancuar elektronik</p> <p>1. Nënshkrimi i avancuar elektronik duhet t'i plotësoj kushtet:</p> <p>1.1. të jetë i lidhur vetëm me nënshkruesin;</p> <p>1.2. të mundësoj identifikimin e qartë të nënshkruesit;</p> <p>1.3. të krijohet duke përdorur të dhënat për krijimin e nënshkrimit elektronik të cilat janë në kontroll të vetëm të nënshkruesit.</p> <p>1.4. të jetë i lidhur me të dhënat që nënshkruan në atë mënyrë që çdo ndryshim i mëvonshëm ne to është i detektueshëm.</p> <p>2. Nënshkrimi i avancuar elektronik, i cili është i bazuar në një certifikatë elektronike të lëshuar nga cilido shtet anëtar i BE-së njihet si nënshkrim i avancuar elektronik në Kosovë, nëse i plotëson kushtet e caktuara në paragrafin 1 të këtij neni.</p>	<p>2. A qualified electronic signature shall have the equivalent legal effect of a handwritten signature and can replace it.</p> <p style="text-align: center;">Article 33 Advanced electronic signature</p> <p>1. The advanced electronic signature must:</p> <p>1.1. be uniquely linked to the signatory;</p> <p>1.2. be capable of identifying the signatory;</p> <p>1.3. use data to create an electronic signature, which is under the sole control of the signatory.</p> <p>1.4. be linked to the data that it signs, in a way that would detect any subsequent change in them.</p> <p>2. The advanced electronic signature, based on an electronic certificate issued by any EU Member State, shall be recognized as an advanced electronic signature in Kosovo, if it meets the requirements provided under paragraph 1 of this Article.</p>	<p>2. Kvalifikovani elektronski potpis ima isti pravni efekat kao ručni potpis i može da zameni isti.</p> <p style="text-align: center;">Član 33 Napredni elektronski potpis</p> <p>1. Napredni elektronski potpis treba da ispuni uslove:</p> <p>1.1. da je povezan samo sa potpisnikom;</p> <p>1.2. da omogući jasnu identifikaciju potpisnika;</p> <p>1.3. da se kreira korišćenjem podataka za stvaranje elektronskog potpisa koje su pod isključivom kontrolom potpisnika.</p> <p>1.4. da je povezan sa podacima koje potpisuje tako da se bilo kakva naredna promena može detektovati.</p> <p>2. Napredni elektronski potpis, koji je zasnovan na elektronskom sertifikatu izdatu od bilo koje države članice EU-a poznat je kao napredni elektronski potpis na Kosovu, ukoliko ispuni uslove određene u stavu 1. ovog člana.</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;">Neni 34 Përgjashtimet e përdorimit të nënshkrimit elektronik</p> <p>1. Nënshkrimi elektronik nuk mund të përdoret në rastet e mëposhtme:</p> <p>1.1. Në fushën e së drejtës familjare dhe të trashëgimisë, të cilat u nënshtrohen kërkesave të veçanta ligjore.</p> <p>1.2. Në veprime juridike për të cilat kërkohet legalizim publik, akt noterial ose autorizim nga gjykata.</p> <p>1.3. Në veprimet ligjore që lidhen me garancinë pasurore për lirimet me kusht.</p> <p>1.4. Kurdoherë kur me ligj të veçant nuk lejohet përdorimin e formës elektronike të nënshkrimit elektronik.</p> <p>2. Nënshkrimi elektronik konsiderohet i pavlefshëm, kur vërtetohet se nuk i ka përbushur kërkesat e sigurisë të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.</p>	<p style="text-align: center;">Article 34 Exception to the use of electronic signature</p> <p>1. Electronic signature cannot be used in the following cases:</p> <p>1.1. In the field of family law and inheritance law, which are subject to special legal requirements.</p> <p>1.2. In legal actions which require public legalization, a notarial act or a court authorization.</p> <p>1.3. In legal actions related to bail for conditional release.</p> <p>1.4. Whenever the use of the electronic signature form is not allowed by a special law.</p> <p>2. The electronic signature shall be considered invalid when it is verified that it has failed to comply with the security requirements set forth in this law and sub-legal acts regarding its application.</p>	<p style="text-align: center;">Član 34 Izuzeci korišćenja elektronskog potpisa</p> <p>1. Elektronski potpis se ne može koristiti u sledećim slućajevima:</p> <p>1.1. U oblasti porodićnog prava i prava nasleđivanja, koja podležu posebnim zakonskim zahtevima.</p> <p>1.2. U pravnim postupcima za koje se zahteva javna legalizacija, notarski akt ili ovlašćenje suda.</p> <p>1.3. U pravnim radnjama koje se odnose na imovinsku garanciju za uslovno oslobađanje.</p> <p>1.4. Kad god se posebnim zakonom ne dozvoljava korišćenje elektronskog oblika elektronskog potpisa.</p> <p>2. Elektronsko potpisivanje smatra se nevažećim, kada se utvrdi da nije ispunio zahteve bezbednosti određenih ovim zakonom i podzakonskim aktima u njegovom sprovođenju.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 35 Kushtet që plotëson një certifikatë e kualifikuar për nënshkrimin elektronik</p> <p>1. Certifikata e kualifikuar për nënshkrimin elektronik është një certifikatë për nënshkrim të kualifikuar elektronik që përmban</p>	<p style="text-align: center;">Article 35 Requirements for qualified certificates for electronic signatures</p> <p>1. A qualified electronic signature certificate is a qualified certificate for electronic signature that contains the</p>	<p style="text-align: center;">Član 35 Uslovi koje ispunjava kvalifikovani sertifikat za elektronsko potpisivanje</p> <p>1. Kvalifikovani sertifikat za elektronsko potpisivanje je sertifikat za kvalifikovani elektronski potpis koji sadrži informaciju</p>

<p>informacionin e përcaktuar me këtë ligj dhe lëshohet nga një ofrues i kualifikuar i shërbimit të besuar.</p> <p>2. Certifikata e kualifikuar për nënshkrimin elektronik duhet të përmbajë:</p> <p>2.1. një shenjë në formën e përshtatshme për punim automatik, që tregon se certifikata elektronike mund të përdoret si certifikatë të kualifikuar për nënshkrim elektronik;</p> <p>2.2. një grup të dhënash që e identifikojnë subjektin juridik ose fizik që lëshon certifikatën e kualifikuar për nënshkrim elektronik, vendin në të cilin është i regjistruar dhe këto:</p> <p>2.2.1. për person juridik: emri, numri unik identifikues.</p> <p>2.2.2. për një person fizik: emri dhe mbiemri, numri personal, emri i babait ose nënës, pseudonimi nëse ka, data e lindjes, vendbanimi rezident ose i përkohshëm;</p> <p>2.3. një grup të dhënash që e identifikojnë në mënyrë unike nënshkruesin : emri dhe mbiemri, numri personal, emri i babait ose i nënës, pseudonimi nëse ka, data e lindjes, vendbanimi rezident ose i përkohshëm;</p> <p>2.4. të dhënat për verifikimin e nënshkrimit elektronik, të cilat korrespondojnë me të dhënat për krijimin</p>	<p>information provided by this law and is issued by a qualified trust service provider.</p> <p>2. Qualified certificate for electronic signature shall contain:</p> <p>2.1. an indication, at least in a form suitable for automated processing, that the certificate has been issued as a qualified certificate for electronic signature;</p> <p>2.2. a set of data identifying the legal or natural entity issuing the qualified certificate for electronic signature, the country in which it is registered, and:</p> <p>2.2.1. for a legal person: the name and unique identification number.</p> <p>2.2.2. for a natural person: the name and surname, personal number, father or mother's name, his or her alias, if any, date of birth, dwelling or place of residence;</p> <p>2.3. a set of data that uniquely identifies the signatory: name and surname, personal number, father or mother's name, pseudonym if any, date of birth, residence or place of residence;</p> <p>2.4. electronic signature validation data that corresponds to the electronic</p>	<p>određenu ovim zakonom i izdaje se od strane kvalifikovanog pružaoca usluge od poverenja.</p> <p>2. Kvalifikovani sertifikat za elektronski potpis treba da sadrži:</p> <p>2.1. oznaku u odgovarajućem obliku za automatsku obradu, koja pokazuje da se elektronski sertifikat može koristiti kao kvalifikovani sertifikat za elektronski potpis;</p> <p>2.2. grupu podataka koji identifikuju pravni ili fizički subjekat koji izdaje kvalifikovani sertifikat za elektronsko potpisivanje, mesto u kojem je registrovan i to:</p> <p>2.2.1. za pravno lice: ime, jedinstveni identifikacioni broj.</p> <p>2.2.2. za fizičko lice: ime i prezime, lični broj, ime jednog roditelja, pseudonim ukoliko postoji, datum rođenja, rezidentno ili privremeno prebivalište;</p> <p>2.3. grupu podataka koji ja jedinstven način identifikuju potpisnika: ime i prezime, lični broj, ime jednog roditelja, pseudonim ukoliko postoji, datum rođenja, rezidentno ili privremeno prebivalište;</p> <p>2.4. podaci za verifikaciju elektronskog potpisa, koji odgovaraju podacima za</p>
--	---	---

<p>e e këtij nënshkrimi dhe të cilat janë nën kontrollin e nënshkruesit;</p> <p>2.5. të dhënat mbi periudhën e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar për nënshkrimin elektronik;</p> <p>2.6. kodin e identifikimit të certifikatës së lëshuar, e cila duhet të jetë unike për ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar;</p> <p>2.7. nënshkrimin ose vulën e avancuar elektronike të ofruesit kualifikuar të shërbimit të besuar i cili lëshon certifikatën;</p> <p>2.8. lokacionin ku certifikata sipas nënparagjit 2.7 lëshohet pa pagesë;</p> <p>2.9. vendndodhjen e shërbimit i cili bënë kontrollimin e kërkesave për validitet të një certifikate të kualifikuar për nënshkrimin elektronik;</p> <p>2.10. një tregues se të dhënat për krijimin e një nënshkrimi elektronik, të cilat korrespondojnë me të dhënat e verifikimit të nënshkrimit elektronik nga një certifikate e kualifikuar, përmbahen në një pajisje të kualifikuar për krijimin e një nënshkrimi elektronik.</p> <p>3. Përveç të dhënave të përmendura në paragrafin 2 të këtij neni , certifikata e kualifikuar mund të përmbajë edhe të dhëna të tjera mbi parashtruesin e kërkesës nëse kjo</p>	<p>signature creation data and which are under the control of the signatory;</p> <p>2.5. the data on the validity period of qualified certificate for electronic signature;</p> <p>2.6. the electronic certificate identity code, that must be unique for the qualified trust service provider;</p> <p>2.7. the advanced electronic seal or signature of issuing qualified trust service provider;</p> <p>2.8. the location where the certificate under the subparagraph 2.7 is available free of charge;</p> <p>2.9. the location of the services to enquire about the validity status of the qualified certificate for electronic signature;</p> <p>2.10. an indication that the data for creation of an electronic signature, corresponding to qualified certificate for electronic signature verification data, are in a qualified means for the creation of an electronic signature.</p> <p>3. The qualified certificate, in addition to the data referred to in paragraph 2 of this Article, may also contain other data on the applicant of the request if this is required</p>	<p>stvaranje ovog potpisa i koji su pod kontrolom potpisnika;</p> <p>2.5. podaci o periodu validnosti kvalifikovanog sertifikata za elektronski potpis;</p> <p>2.6. identifikacioni kod izdatog sertifikata, koji treba da bude jedinstven za kvalifikovanog pružaoca usluge od poverenja;</p> <p>2.7. potpis ili napredni elektronsko pečat za kvalifikovane pružaoce usluge od poverenja koji izdaju sertifikat;</p> <p>2.8. lokaciju gde se sertifikat u skladu sa prema tački 2.7 izdaje besplatno;</p> <p>2.9. lokaciju službe koja vrši kontrolisanje zahteva za validaciju jednog kvalifikovanog sertifikata za elektronski potpis;</p> <p>2.10. jedan pokazatelj da podaci za stvaranje jednog elektronskog potpisa, koji odgovaraju sa podacima verifikacije elektronskog potpisivanja od jednog kvalifikovanog sertifikata, sadrže se u kvalifikovanom uređaju za stvaranje elektronskog potpisa.</p> <p>3. Pored podataka iz stava 2. ovog člana, kvalifikovani sertifikat može sadržati i druge podatke o podnosiocu zahteva ukoliko se to traži od strane potpisnika i ti podaci ne utiču</p>
--	--	--

<p>kërkohet nga nënshkruesi dhe këto të dhëna nuk ndikojnë në ndërveprimin dhe njohjen e nënshkrimit të kualifikuar elektronik.</p> <p style="text-align: center;">Neni 36 Humbja e validitetit dhe pezullimi i përkohshëm i një certifikate të kualifikuar për nënshkrimin elektronik</p> <p>1. Nënshkrimi i kualifikuar elektronik e humb validitetin nëse certifikata e kualifikuar për nënshkrimin elektronik revokohet bazuar në dëshmitë e ofruara pas aktivizimit të saj, në përputhje me paragrafin 1 të nenit 60 të këtij ligji.</p> <p>2. Për rastin nga paragrafi 1 të këtij neni, nënshkrimi elektronik nuk mund të aktivizohet përsëri.</p> <p>3. Nënshkrimi i kualifikuar elektronik e humb validitetin për kohën e pezullimit të certifikatës për nënshkrimin e kualifikuar elektronik nga paragrafi 3 i nenit 60 të këtij ligji.</p> <p>4. Në rastin e paragrafit 3 të këtij neni, nënshkrimi elektronik mund të aktivizohet përsëri, kur të vërtetohet se nuk janë përmbushur kushtet për tërheqjen e certifikatës së kualifikuar nga paragrafi 1 i nenit 60 të këtij ligji.</p> <p style="text-align: center;">Neni 37 Shërbimi i ruajtjes së nënshkrimit të kualifikuar elektronik</p>	<p>by the signatory and this data does not affect the interaction and recognition of the qualified electronic signature.</p> <p style="text-align: center;">Article 36 Loss of validity and temporary suspension of a qualified certificate for electronic signature</p> <p>1. Qualified certificate for electronic signatures has been revoked after initial activation; it shall lose its validity from the moment of its revocation in accordance with paragraph 1 of Article 60 of this Law.</p> <p>2. For the case under paragraph 1 of this Article, an electronic signature cannot be reactivated again.</p> <p>3. The qualified electronic signature shall lose validity for the suspension time of the qualified certificate for the electronic signature from paragraph 3 of Article 60 of this Law.</p> <p>4. In case of paragraph 3 of this Article, the electronic signature may be reactivated when it is verified that the conditions for withdrawing the qualified certificate from paragraph 3 of Article 60 of this Law are not fulfilled.</p> <p style="text-align: center;">Article 37 Qualified preservation service for qualified electronic signatures</p>	<p>na interakciju i priznavanje kvalifikovanog elektronskog potpisa.</p> <p style="text-align: center;">Član 36 Gubitak validnosti i privremena obustava kvalifikovanog sertifikata za elektronski potpis</p> <p>1. Kvalifikovani elektronski potpis gubi validnost ukoliko kvalifikovani sertifikat o elektronskom potpisu bude opozvan na osnovu dokaza dostavljenih nakon njegovog aktiviranja, u skladu sa stavom 1. člana 60. ovog zakona.</p> <p>2. Za slučaj iz stava 1. ovog člana, elektronski potpis se ne može ponovo aktivirati.</p> <p>3. Kvalifikovani elektronski potpis gubi validnost za vreme suspenzije sertifikata za kvalifikovani elektronski potpis iz stava 3. člana 60. ovog zakona.</p> <p>4. U slučaju iz stava 3. ovog člana, elektronski potpis se može ponovo aktivirati kada se utvrdi da nisu ispunjeni uslovi za povlačenje kvalifikovanog sertifikata iz stava 1. člana 60. ovog zakona.</p> <p style="text-align: center;">Član 37 Usluga čuvanja kvalifikovanog elektronskog potpisa</p>
---	---	--

<p>1. Ruajtja e nënshkrimit të kualifikuar elektronik, ofrohet vetëm nga ofruesit e kualifikuar të shërbimeve të besuara përmes përdorimit të procedurave dhe teknologjive të kualifikuara që mund të zgjerojnë besueshmërinë e një nënshkrimi të kualifikuar elektronik edhe përtej periudhës që tejkalon datën e skadimit të teknologjisë.</p> <p>2. Mënyra ruajtjes së nënshkrimit të kualifikuar elektronik bëhet konform legjislacionit për mbrojtjen e të dhënave personale.</p>	<p>1. A qualified preservation service for qualified electronic signatures may only be provided by a qualified trust service provider that uses procedures and technologies capable of extending the trustworthiness of the qualified electronic signature beyond the technological validity period.</p> <p>2. Manner of preserving a qualified electronic signature conforms to the legislation on personal data protection.</p>	<p>1. Sačuvanje kvalifikovanog elektronskog potpisa pruža se samo od strane kvalifikovanih pružaoca usluga od poverenja kroz korišćenje kvalifikovanih procedura i tehnologija koje mogu da prošire kredibilitet kvalifikovanog elektronskog potpisa čak i nakon isteka roka trajanja tehnologije.</p> <p>2. Način čuvanja kvalifikovanog elektronskog potpisa vrši se u skladu sa zakonodavstvom za zaštitu ličnih podataka.</p>
<p>KAPITULLI V VULA ELEKTRONIKE</p> <p style="text-align: center;">Neni 38 Kërkesat e vulës së avancuar dhe të kualifikuar elektronike</p>	<p>CHAPTER V ELECTRONIC SEAL</p> <p style="text-align: center;">Article 38 Requirements of the advanced qualified electronic stamp</p>	<p>POGLAVLJE V ELEKTRONSKI PEČAT</p> <p style="text-align: center;">Član 38 Zahtevi naprednog i kvalifikovanog elektronskog pečata</p>
<p>1. Vulë e avancuar elektronike konsiderohet vula elektronike e cila i plotëson kushtet e mëposhtme:</p> <p>1.1. Lidhet në mënyrë unike me krijuesin e vulës.</p> <p>1.2. Identifikon krijuesin e vulës.</p> <p>1.3. Krijohet duke përdorur të dhënat e krijimit të vulës elektronike, të cilat përdoren vetëm nga krijuesi i vulës.</p>	<p>1. An advanced electronic stamp is considered the electronic stamp that meets the following requirements:</p> <p>1.1. It is uniquely linked to the creator of the stamp.</p> <p>1.2. Identifies the creator of the stamp;</p> <p>1.3. Created using the electronic seal creation data, which is used only by the stamp creator.</p>	<p>1. Naprednim elektronskim pečatom smatra se elektronski pečat koji ispunjava sledeće uslove:</p> <p>1.1. Povezuje se na jedinstven način sa kreatorom pečata.</p> <p>1.3. Identifikuje kreatora pečata.</p> <p>1.3. Kreira se korišćenjem podataka za kreiranje elektronskog pečata, koji se koriste samo od strane kreatora pečata.</p>

<p>1.4. Lidhet ne menyre te tille me te dhënat e vulosura ashtu qe cdo ndryshim i mëvonshëm eshte i detektueshem.</p> <p>2. Vula e kualifikuar elektronik konsiderohet vula e avancuar elektronike e cila krijohet me një pajisje të kualifikuar për vula elektronike dhe bazohet ne certifikate të kualifikuar elektronike.</p>	<p>1.4. Linked to the data to which it relates in a way that would detect any subsequent change in them.</p> <p>2. A qualified electronic stamp shall be considered the advanced electronic stamp created by a qualified means for electronic stamps and is based on a qualified electronic certificate.</p>	<p>1.4. Na sličan način se povezuje sa pečatiranim podacima tako da svako kasnije kašnjenje bude otkriveno.</p> <p>2. Kvalifikovanim elektronskim pečatom smatra se napredni elektronski pečat koji se kreira kvalifikovanim uređajem za elektronske pečate i zasniva se na kvalifikovanom elektronskom pečatu sertifikatu.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 39 Kërkesat vulës së kualifikuar elektronike kohore</p>	<p style="text-align: center;">Article 39 Requirements of the qualified electronic time stamp</p>	<p style="text-align: center;">Član 39 Zahtevi kvalifikovanog elektronskog vremenskog žiga</p>
<p>1. Vula e kualifikuar elektronike kohore është një vulë elektronike kohore që i plotëson kërkesat specifike:</p> <p>1.1. lidh të dhënat sipas datës dhe kohës për të parandaluar çdo mundësi të ndryshimit të tyre;</p> <p>1.2. bazohet në një burim të saktë kohor që lidhet me Kohën e Koordinuar Universale;</p> <p>1.3. përdoret nga ofruesi i një shërbimi për lëshimin e vulave të kualifikuara kohore duke përdorur një nënshkrim të avancuar elektronik ose një vulë të avancuar elektronike.</p> <p>1.4. lëshohet nga ofruesi i kualifikuar i shërbimit për vula kohore.</p>	<p>1. Qualified electronic time stamp is an electronic time stamp that meets specific requirements:</p> <p>1.1. Links data by date and time to prevent the possibility of change;</p> <p>1.2. Is based on an accurate time source that is related to a coordinated universal time;</p> <p>1.3. Is used by a provider of a qualified time stamps issuing service using an advanced electronic signature or an advanced electronic seal;</p> <p>1.4. Is issued by a qualified service provider for time stamps;</p>	<p>1. Kvalifikovani elektronski vremenski žig je vremenski elektronski žig koji ispunjava specifične zahteve:</p> <p>1.1. povezuje podatke prema datumu i vremenu radi sprečavanja bilo koje mogućnosti njihove promene;</p> <p>1.2. zasniva se na tačnom vremenskom izvoru koji se povezuje sa univerzalnim kodiranim vremenom;</p> <p>1.3. koristi se od strane pružaoca usluge za izdavanje kvalifikovanih vremenskih žigova koristeći napredni elektronski potpis ili napredni elektronski pečat.</p> <p>1.4. izdaje se od strane kvalifikovanog pružaoca usluge za vremenske žigove.</p>

<p>2. Kushtet dhe standardet për vulat e kualifikuara elektronike kohore përcaktohen me akt nënligjor.</p> <p style="text-align: center;">Neni 40 Vulat elektronike në shërbimet publike</p> <p>Një institucion publik për shërbimet online të cilat i ofron do të njeh vulat e avancuara elektronike dhe vulat e kualifikuara elektronike.</p> <p style="text-align: center;">Neni 41 Efekti juridik i një vule elektronike</p> <p>1. Vula elektronike konsiderohet e vlefshme dhe e pranueshme dhe nuk mund t'i mohohet vlefshmëria ose pesha e provës vetëm se është në formë elektronike dhe nuk i plotëson kërkesat për vulë të kualifikuar elektronike.</p> <p>2. Një vulë e kualifikuar elektronike siguron ruajtjen e integritetit dhe korrektësisë së origjinës së të dhënave për të cilat është e lidhur.</p> <p>3. Një vulë elektronike e kualifikuar, që mbështetet në një certifikatë të kualifikuar të lëshuar në një nga shtetet e BE-së do të njihet si një vulë e kualifikuar elektronike edhe në Kosovë.</p>	<p>2. The conditions and standards for qualified electronic time stamps shall be determined by a sub-legal act.</p> <p style="text-align: center;">Article 40 Electronic seals in public services</p> <p>A public institution shall recognize advanced electronic seals and qualified electronic seals for online services it offers.</p> <p style="text-align: center;">Article 41 Legal effect of electronic seals</p> <p>1. An electronic seal shall be considered valid and admissible and shall not be denied legal effect and admissibility as evidence in legal proceedings solely on the grounds that it is in an electronic form or that it does not meet the requirements for qualified electronic seals.</p> <p>2. A qualified electronic seal shall enjoy the presumption of integrity of the data and of correctness of the origin of that data to which the qualified electronic seal is linked.</p> <p>3. A qualified electronic seal based on a qualified certificate issued in an EU Member State shall be recognized as a qualified electronic seal in Kosovo.</p>	<p>2. Uslovi i standardi za kvalifikovane elektronske vremenske žigove određuju se podzakonskim aktom.</p> <p style="text-align: center;">Član 40 Elektronski pečati u javnim službama</p> <p>U javnoj instituciji za online usluge koje pruža priznaće napredne elektronske pečate i kvalifikovane elektronske pečate.</p> <p style="text-align: center;">Član 41 Pravni efekat elektronskog pečata</p> <p>1. Elektronski pečat smatra se validnim i prihvatljivim i ne može se uskratiti valjanost ili težina dokaza samo zato što je u elektronskom obliku i ne ispunjava zahteve za kvalifikovani elektronski pečat.</p> <p>2. Kvalifikovani elektronski pečat obezbeđuje čuvanje integriteta i tačnosti porekla podataka na koje se odnosi.</p> <p>3. Kvalifikovani elektronski pečat, koji se zasniva na kvalifikovanom sertifikatu izdatim od strane jedne od EU zemalja biće priznat kao kvalifikovani elektronski pečat i na Kosovu.</p>
--	--	---

<p align="center">Neni 42 Kushtet e nevojshme për Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike</p>	<p align="center">Article 42 Requirements for qualified certificates for electronic seals</p>	<p align="center">Član 42 Neophodni uslovi za kvalifikovane sertifikate za elektronske pečate</p>
<p>1. Certifikata e kualifikuar për vulat elektronike përmban:</p> <p>1.1. një tregues në formë të përshtatshme për përpunim automatik i cili dëshmon se certifikata është lëshuar si certifikatë e kualifikuar për krijimin e vulës elektronike;</p> <p>1.2. një grup të dhënash të cilat identifikojnë në mënyrë unike dhe të sigurt ofruesin e kualifikuar të shërbimit të besuar i cili lëshon certifikatën e kualifikuar, përfshirë:</p> <p>1.2.1. emrin dhe numrin unik të identifikimit për personin juridik; dhe</p> <p>1.2.2. emrin dhe mbiemrin , për personin fizik</p> <p>1.3. të dhënat për vërtetimin e vlefshmërisë së vulës elektronike, të cilat korrespondojnë me të dhënat për krijimin e një vule elektronike;</p> <p>1.4. emrin e i krijuesit të vulës dhe kur është e mundur edhe numrin i regjistrimit siç është përcaktuar në shënimet zyrtare;</p> <p>1.5. të dhënat mbi periudhën e vlefshmërisë së certifikatës;</p>	<p>1. Qualified certificates for electronic seals shall contain:</p> <p>1.1. An indication, at least in a form suitable for automated processing, that the certificate has been issued as a qualified certificate for the creation of electronic seal;</p> <p>1.2. A set of data unambiguously representing the qualified trust service provider issuing the qualified certificates including:</p> <p>1.2.1. for a legal person: the name and the unique registration number; and</p> <p>1.2.2. for a natural person: the person’s name and surname;</p> <p>1.3. electronic seal validation data, which corresponds to the electronic seal creation data;</p> <p>1.4. the name of the creator of the seal and, where applicable, registration number as stated in the official records;</p> <p>1.5. details of the beginning and end of the certificate’s period of validity;</p>	<p>1. Kvalifikovani sertifikat za elektronske pečate sadrži:</p> <p>1.1. oznaku u pogodnom obliku za automatsku obradu koja dokazuje da je sertifikat izdat kao kvalifikovani sertifikat za izradu elektronskog pečata;</p> <p>1.2. grupu podataka koji na jedinstven i siguran način identifikuju kvalifikovanog pružaoca usluge od poverenja koji izdaje kvalifikovani sertifikat, uključujući:</p> <p>1.2.1. naziv i jedinstveni identifikacioni broj pravnog lica; i</p> <p>1.2.2. ime i prezime, za fizičko lice;</p> <p>1.3. podaci o potvrđivanju validnosti elektronskog pečata, koji odgovaraju podacima za stvaranje elektronskog pečata;</p> <p>1.4. ime kreatora pečata i kada je to moguće i registarski broj kao što je određeno u zvaničnim beleškama;</p> <p>1.5. podaci o periodu validnosti sertifikata;</p>

<p>1.6. kodin e identifikimit të certifikatës, i cili duhet të jetë unik për ofruesin e kualifikuar të shërbimeve të besuara;</p> <p>1.7. nënshkrimin elektronik ose vulën elektronike të avancuar të ofruesit të kualifikuar të shërbimeve të besuara, i cili lëshon certifikatën;</p> <p>1.8. vendin ku një certifikatë përkatëse, sipas paragrafit 1.7. të këtij neni, mund të gjendet pa pagesë;</p> <p>1.9. vendndodhjen e shërbimit që mund të përdoret për verifikimin e statusit të e vlefshmërisë së certifikatës së kualifikuar;</p> <p>1.10. treguesin se të dhënat për krijimin e nënshkrimit elektronik ose vulës, të cilat korrespondojnë me të dhënat për validimin e nënshkrimit elektronik ose vulës nga një certifikatë e kualifikuar elektronike, përfshihen në një pajisje të kualifikuar për krijimin e një nënshkrimi elektronik ose vule.</p>	<p>1.6. the certificate identity code, which must be unique for the qualified trust service provider;</p> <p>1.7. the advanced electronic signature or advanced electronic seal of the issuing qualified trust service provider;</p> <p>1.8. location where a relevant certificate, according to paragraph 1.7 of this Article, is available free of charge;</p> <p>1.9. the location of the services that can be used to enquire as to the validity status of the qualified certificate;</p> <p>1.10. the indicator that the electronic signature or seal creation data, which corresponds to the electronic signature or the seal validation data from a qualified electronic certificate, is included in a qualified electronic signature or seal creation devices.</p>	<p>1.6. identifikacioni kod certifikata, koji treba da bude jedinstven za kvalifikovanog pružaoca usluga od poverenja;</p> <p>1.7. elektronski potpis ili napredni elektronski pečat kvalifikovanog pružaoca usluga od poverenja, koji izdaje certifikat;</p> <p>1.8. mesto gde se relevantni certifikat, u skladu sa stavom 1.7. ovog člana, može nalaziti besplatno;</p> <p>1.9. lokaciju usluge koja se može koristiti za verifikaciju statusa validnosti kvalifikovanog certifikata;</p> <p>1.10. oznaku da su podaci za stvaranje elektronskog potpisa ili pečata, koji odgovaraju podacima za validaciju elektronskog potpisa ili pečata od kvalifikovanog elektronskog certifikata obuhvaćeni u kvalifikovanom uređaju za stvaranje elektronskog potpisa ili pečata.</p>
<p style="text-align: center;">Neni 43 Certifikatat e kualifikuara për vulat elektronike</p>	<p style="text-align: center;">Article 43 Qualified certificates for electronic seals</p>	<p style="text-align: center;">Član 43 Kvalifikovani sertifikati za elektronske pečate</p>
<p>1. Certifikata e kualifikuar për vula elektronike përfshinë attribute jo të detyrueshme shtesë, nëse këto attribute nuk ndikojnë në ndërveprimin dhe njohjen e vulave të kualifikuara elektronike.</p>	<p>1. Qualified certificates for electronic seals may include non-mandatory additional attributes, if those attributes shall not affect the interoperability and recognition of qualified electronic seals.</p>	<p>1. Kvalifikovani certifikat za elektronske pečate obuhvata dodatne neobavezujuće attribute, ukoliko ti atributi ne utiču na interakciju i priznavanju kvalifikovanih elektronskih pečata.</p>

<p>2. Nëse një certifikatë e kualifikuar për vula elektronike është revokuar pas aktivizimit fillestar, ajo humb vlefshmërinë e saj nga momenti i revokimit dhe statusi i saj nuk rikthehet në asnjë rrethanë.</p> <p>3. Nëse certifikata e kualifikuar për vula elektronike pezullohet përkohësisht, kjo certifikatë do të humbasë vlefshmërinë e saj për periudhën e pezullimit;</p> <p>4. Periudha e pezullimit të certifikatës së kualifikuar për vulat elektronike tregohet qartë në bazën e të dhënave të certifikatave dhe statusi i pezullimit është i dukshëm gjatë periudhës së pezullimit, nga shërbimi që ofron informacion mbi statusin e certifikatës.</p> <p>5. Rregullat për pezullimin e përkohshëm të certifikatave të kualifikuara për vulat elektronike dhe standardet e nevojshme përcaktohen me akt nënligjor dhe në përputhje me kërkesat e nenit 42 të këtij ligji.</p>	<p>2. If a qualified certificate for an electronic seal has been revoked after initial activation, it shall lose its validity from the moment of its revocation, and its status shall not in any circumstances be reverted.</p> <p>3. If a qualified certificate for electronic seal has been temporarily suspended, that certificate shall lose its validity for the period of suspension;</p> <p>4. The period of suspension of a qualified certificate for electronic seals shall be clearly indicated in the certificate database and the suspension status shall be visible, during the period of suspension, from the service providing information on the status of the certificate.</p> <p>5. The rules for the temporary suspension of qualified certificates for electronic seals and necessary standards shall be determined by a sub-legal act and in accordance with the requirements of Article 42 of this Law.</p>	<p>2. Ukoliko je jedan kvalifikovani sertifikat za elektronske pečate povučen nakon inicijalnog aktiviranja, onda gubi svoju validnost od trenutka povlačenja i njegov status se ne vraća ni po kojim okolnostima.</p> <p>3. Ukoliko se kvalifikovani sertifikat za elektronske pečate povuče privremeno, ovaj sertifikat će izgubiti svoju validnost za period povlačenja;</p> <p>4. Period povlačenja kvalifikovanog sertifikata za elektronske pečate se prikazuje jasno u bazi podataka sertifikata i status povlačenja je vidljiv tokom perioda povlačenja, od usluge koja pruža informaciju o statusu sertifikata.</p> <p>5. Pravila za privremeno povlačenje kvalifikovanih sertifikata za elektronske pečate i neophodne standarde određuju se podzakonskim aktom i u skladu sa zahtevima člana 42. ovog zakona.</p>
<p>KAPITULLI VI</p> <p>PAJISJET PËR KRIJIMIN E NËNSHKRIMEVE DHE VULAVE ELEKTRONIKE DHE CERTIFIKIMI</p> <p>Neni 44 Pajisjet për krijimin e një nënshkrimi ose vule elektronike</p>	<p>CHAPTER VI</p> <p>ELECTRONIC SIGNATURE AND ELECTRONIC SEAL CREATION DEVICES AND CERTIFICATION</p> <p>Article 44 Electronic signature or electronic seal creation devices</p>	<p>POGLAVLJE VI</p> <p>OPREMA ZA IZRADU ELEKTRONSKIH POTPISA I PEČATA I SERTIFIKACIJA</p> <p>Član 44 Oprema za izradu elektronskog potpisa ili pečata</p>

<p>1. Pajisjet për krijimin e një nënshkrimi ose vule elektronike janë pajisjet ose programet kompjuterike të cilat shfrytëzohen për krijimin e një nënshkrimi ose vule elektronike, përmes shfrytëzimit të të dhënave për krijimin e një nënshkrimi ose vule elektronike.</p> <p>2. Pajisjet nga paragrafi 1 i këtij neni u jepen personave fizikë ose personave juridik përmes skemave të identifikimit elektronik të cilin e shfrytëzon ofruesi i shërbimeve të besuara.</p>	<p>1. Electronic signature or electronic seal creation devices are the corresponding computer devices or computer software used for electronic signature or electronic seal creation, using the data on electronic signature or electronic seal creation.</p> <p>2. Devices referred to in paragraph 1 of this Article shall be provided to natural persons or legal persons through the electronic identification scheme used by the trust service provider.</p>	<p>1. Oprema za izradu elektronskog potpisa ili pečata je oprema ili kompjuterski programi koji se koriste za izradu elektronskog potpisa ili pečata, kroz korišćenje podataka za izradu elektronskog potpisa ili pečata.</p> <p>2. Oprema iz stava 1. ovog člana se daje fizičkim ili pravnim licima putem šema elektronske identifikacije kojeg koristi pružalac usluga od poverenja.</p>
<p>Neni 45 Pajisjet e kualifikuara për krijimin e nënshkrimeve dhe vulave elektronike</p>	<p>Article 45 Qualified electronic signature and electronic seal creation devices</p>	<p>Član 45 Kvalifikovana oprema za izradu elektronskih potpisa i pečata</p>
